Vendim nr. 291, datë 16.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 16.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **DAUT ELMAZI, IGLI MEMAJ, ALBANO GOXHAJ, GENTJAN DAUTAJ, SERXHIO CIMA (ADEMI),** të përfaqësuar nga avokat Artan Kodheli, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 509, datë 21.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 1387 (30-2023-4941), datë 15.09.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-1818, datë 02.12.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, 17, 29, 30, 42 dhe 131, shkronja "f", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 20, 21, 22, 24, 25, 27, 31, 71, 71/a, 72, 73 dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (*Prokuroria e Vlorës*) dhe janë akuzuar për veprën penale të vrasjes në rrethana cilësuese, të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 79/dh, 22 e 25 të Kodit Penal (*KP*), ndërsa kërkuesi Gentjan Dautaj edhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake në mjedise publike, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së. Procedimi ka të bëjë me ngjarjen e ndodhur në datën 10.05.2019, ku në afërsi të një kompleksi në lagjen "Uji i Ftohtë" të qytetit të Vlorës, nga një automjet është qëlluar me armë zjarri në dëm të tre shtetasve.

2. Në përfundim të hetimeve paraprake, në datën 05.11.2020, Prokuroria e Vlorës ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, e cila është pranuar nga gjyqtari i seancës paraprake me vendimin e datës 26.01.2021.

3. Pas shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (*Gjykata e Vlorës*), me vendimin nr. 509, datë 21.11.2022, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesve sipas akuzave dhe i ka dënuar respektivisht: Daut Elmazi dhe Gentjan Dautaj (Zoto) me nga 35 vjet burgim secilin; Igli Memaj (Suloti) me 30 vjet burgim; Serxhio Cima (Ademi) dhe Albano Goxhaj me nga 25 vjet burgim secilin.

4. Ndonëse kërkuesit kanë paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (*Gjykata e Apelit*) me vendimin nr. 1387 (30-2023-4941), datë 15.09.2023. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1818, datë 02.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, pasi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

5. Në datën 02.06.2026 kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesve

6. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se nga vendimet e kundërshtuara u janë cenuar:

6.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë përmbushur detyrimin për të verifikuar dhe vërtetuar fajësinë përtej dyshimit të arsyeshëm. Hetimi nuk ka qenë i plotë dhe i paanshëm, ndërsa dyshimet janë interpretuar në disfavor të tyre. Kështu, fajësia e tyre është bazuar në deklarimet hetimore të një personi që nuk u gjet të pyetej në gjykim, si dhe në dëshminë e një personi që nuk kishte pranuar të përgjigjej në gjykim, ndonëse gjatë hetimit kishte dhënë deklarime të hollësishme. Prokuroria nuk ka dhënë shpjegime, ndërsa gjykatat nuk kanë verifikuar se përse në ditën e ngjarjes (10.05.2019) kërkuesi Daut Elmazi ishte vendosur në përgjim, në kushtet kur deklarimet që e inkriminonin atë janë dhënë 6 muaj pas ngjarjes (13.11.2019 dhe 04.12.2019).

6.2. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor bazuar në prova të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, e garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, pasi: (i) procesverbali i sekuestrimit të provës materiale dorezë e zezë, në kundërshtim me nenin 188 të KPP-së nuk përshkruan me hollësi llojin e materialit, cilës dorë i përkiste, ndonjë shenjë të posaçme, përmasat, nëse është e djegur ose jo, sesi është brenda, çfarë ngjyre ka, trashësia dhe hollësi të tjera të detyrueshme; (ii) deklarimet e dy prej personave që kanë dijeni për ngjarjen, në kundërshtim me nenet 36 dhe 167 të KPP-së, janë dhënë në cilësinë e të pandehurve në një procedim të lidhur, për njërin prej tyre nuk janë ezuaruar të gjitha mjetet e njoftimit, megjithëse policia ishte në dijeni që ai ndodhej jashtë shtetit, ndërsa personi tjetër nuk ka pranuar të pyetet; (iii) pretendimi për falsitetin e aktit të ekspertimit biologjik për shkak të numrit dhe datës duhet të ishte verifikuar duke marrë informacion nga Instituti i Policisë Shkencore dhe jo duke u mjaftuar me përgjigjen e prokurorit.

6.3. *Liria e lëvizjes dhe parimi i sigurisë juridike*, pasi kërkuesit janë dënuar gjithsej me 153 vjet burgim. Dënimi është joproporcional në raport me pasojën – vetëm plagosje e lehtë e një personi dhe asnjë dëm material. Dënime të tilla nuk janë caktuar asnjëherë në Shqipëri, masa e dënimit tejkalon represivitetin e pritshëm në kushtet

kur vepra penale ka mbetur në tentativë. Ligji parashikon dënim me burgim nga 20 vjet deri në 35 vjet burgim ose burgim të përjetshëm për veprën penale të vrasjes në rrethana cilësuese dhe gjykatat duhet të kishin caktuar dënimin drejt minimumit.

6.4. *E drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar neni 42 i Kushtetutës në aspektet e mëposhtme:

6.4.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi gjyqtarja që kryesonte trupin gjykues në gjykimin në shkallë të parë, sipas skemës së delegimit ishte caktuar gjyqtare në gjykatën e apelit, ndaj nuk ishte kompetente nga pikëpamja funksionale. Ky pretendim nuk u shqyrtua as nga Gjykata e Lartë, për pasojë pas 7 vjetësh nga arrestimi ende nuk është dhënë një vendim nga një gjykatë e caktuar me ligj.

6.4.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* pasi Gjykata e Apelit, në mënyrë të njëanshme, ka rrëzuar të gjitha kërkesat procedurale të kërkuesve. Ndërsa një prej anëtarëve të trupit gjykues në gjykimin në shkallë të dytë është caktuar në datën 13.09.2023 dhe ka marrë pjesë në shpalljen e vendimit gjyqësor në datën 15.09.2023, duke qenë në pamundësi të dukshme për t'u njohur me dosjen gjyqësore tejet voluminoze.

6.4.3. *E drejta për t'u mbrojtur dhe parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoriteti,* pasi gjykatat e faktit u kanë mohuar kërkuesve marrjen dhe shqyrtimin e provave në favor të tyre, duke u mbështetur kryesisht në provat e organit të akuzës dhe duke i dhënë këtij të fundit përparësi në kërkimet e tij. Ndërkohë, gjykatat i kanë dhënë vlerë dëshmisë së një personi, që nuk mbështetet në prova të tjera për veprën penale të vrasjes në rrethana cilësuese.

6.4.4. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e të tria gjykatave, pavarësisht volumit të tyre, nuk përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm për pretendimet e mbrojtjes. Në veçanti, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje vetëm pjesërisht shkaqeve të rekursit, përmes një arsyetimi të përmbledhur dhe citimeve të përgjithshme, pa analizuar pretendimet për zbatimin e ligjit dhe cenimin e të drejtave themelore. Për rrjedhojë, kërkuesit nuk kanë marrë përgjigje efektive dhe as kanë mundur të kuptojnë arsyet thelbësore që kanë çuar në mospranimin e rekursit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

7. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret paraprake të legjitimimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

9. Në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në shqyrtimin e legjitimimit *ratione materiae* të kërkuesve që ka të bëjë me natyrën kushtetuese të pretendimeve. Në këtë drejtim, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, së drejtës për të mos u deklaruar fajtor bazuar në prova të mbledhura në mënyrë të paligjshme, lirisë së lëvizjes në mënyrë joproporcionale, parimit të sigurisë juridike, si dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte (e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj dhe e paanshme, drejta për t'u mbrojtur, parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit dhe standardi i arsyetimit). Këto parime dhe të drejta garantohen nga nenet 30, 32 e 42 të Kushtetutës dhe *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

10. Lidhur me pretendimin për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, kërkuesit kanë parashtruar se fajësia e tyre është deklaruar mbi bazën e dyshimeve, të cilat janë vlerësuar në disfavor të tyre (*shih supra paragrafin 6.1.*).

11. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm *(shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime *(shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

12. Mbi bazën e këtyre standardeve, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit tërësor të provave, ka çmuar se provohej kryerja e veprës penale në bashkëpunim nga kërkuesit, duke evidentuar faktin penal, dijeninë e secilit për veprën, kontributin dhe rolin konkret të secilit prej tyre në realizimin e saj. Në këtë drejtim, gjykata është mbështetur, ndër të tjera, në pamjet filmike të kamerave të lokalit ku ka ndodhur ngjarja, dëshmitë e viktimave dhe të personave të tjerë të pranishëm, përfshirë personin e plagosur, si dhe në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes. Sipas saj, nga këto prova rezultonte lëvizja e mjetit të përdorur nga kërkuesit dhe ndalimi i tij përballë lokalit ku ndodheshin viktimat, zbritja e njërit prej autorëve me armën të drejtuar ndaj tyre, të shtënat në drejtim të lokalit, largimi i viktimave dhe kundërpërgjigjja me armë e njërit prej tyre, si dhe plagosja e një personi tjetër. Vendi dhe mënyra e plagosjes së këtij të fundit, të vlerësuara së bashku me provat e tjera, kanë shërbyer gjithashtu për të arritur në përfundimin se është qëlluar në lartësinë e personave dhe jo në ajër.

13. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar, po ashtu, se kërkuesit kishin kryer veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale, konkretisht kishin siguruar armët e zjarrit dhe mjetin, kishin shkuar në vendin ku ndodheshin viktimat dhe kishin qëlluar në drejtim të tyre, ndërsa njëri prej autorëve ishte afruar më tej ndaj njërit prej viktimave dhe kishte drejtuar ndaj tij armën automatike, e cila ishte bllokuar. Sipas gjykatës, pasoja nuk kishte ardhur për shkaqe të pavarura nga vullneti i autorëve, konkretisht për shkak të bllokimit të armës, largimit të viktimave dhe kundërpërgjigjes me armë të njërit prej tyre, rrethana që përligjnin cilësimin e veprës si të mbetur në tentativë. Në këtë vlerësim ajo ka marrë në konsideratë edhe rezultatet e procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, në veçanti faktin se armët ishin gjetur jashtë mjetit të djegur, si dhe

gjetjen e një dorashke në afërsi të vendit ku ishin djegur armët. Mbi këtë analizë tërësore të rrethanave dhe të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se akuza ndaj kërkuesve ishte provuar.

14. Në vijim, Gjykata e Apelit e ka vlerësuar të drejtë analizën e gjykatës së shkallës së parë, duke evidentuar se konkluzioni për fajësinë e kërkuesve mbështetej në provat e administruara në dosjen gjyqësore, të cilat, në kuadër të gjykimit të zakonshëm, i ishin nënshtruar shqyrtimit dhe debatit gjyqësor, si dhe ishin marrë e vlerësuar në përputhje me nenin 152 të KPP-së. Sipas gjykatës së apelit, tërësia e këtyre provave përmbushte standardin e parashikuar nga neni 4 i KPP-së, duke provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerjen nga kërkuesit të veprave penale për të cilat ishin deklaruar fajtorë.

15. Edhe Gjykata e Lartë ka evidentuar se gjykata e apelit kishte analizuar provat e marra dhe të verifikuara gjatë procesit në përputhje me kërkesat e nenit 152 të KPP-së, duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm për përgjegjësinë penale të kërkuesve. Sipas saj, përfundimi për fajësinë e tyre ishte mbështetur në prova që vërtetonin, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, akuzat e ngritura ndaj tyre.

16. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se, ndryshe nga sa pretendojnë kërkuesit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë individualizuar përgjegjësinë penale të secilit prej tyre, duke përcaktuar veprimet konkrete, rolin dhe kontributin e tyre në kryerjen e veprave penale. Përfundimet për fajësinë nuk janë mbështetur thjesht në akuzën e prokurorisë ose në prova të izoluara, por në vlerësimin tërësor dhe të kryqëzuar të provave të administruara gjatë gjykimit, ku përfshiheshin pamjet filmike, deklarimet, përgjimet dhe transkriptet e komunikimeve, si dhe rezultatet e akteve të ekspertimit. Mbi bazën e kësaj analize, gjykatat kanë arsyetuar se tërësia e provave ishte e mjaftueshme për të vërtetuar, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, përgjegjësinë penale të kërkuesve për veprat për të cilat janë deklaruar fajtorë. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

17. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor bazuar në prova të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, kërkuesit kanë parashtruar se disa prova mbi të cilat është bazuar vendimi i fajësisë (automjeti i djegur, ekspertimi biologjik i dorezës dhe deklarimet hetimore të dy të pandehurve të tjerë në procedime të lidhura) nuk janë marrë sipas rregullave ligjore procedurale (*shih supra paragrafin 6.2.*).

18. Kushtetuta parashikon se kushdo ka të drejtën për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme (*neni 32, pika 2*). Nën frymën e kësaj dispozite,

Gjykata ka theksuar se asnjë gjykatë nuk ka mundësi, që pa dëmtuar dhënien e "përmasës së duhur të drejtësisë", të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme (*shih vendimet nr. 55 datë 10.10.2025; nr. 67 datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës (*shih vendimet nr. 9, datë 26.02.2015; nr. 40, datë 22.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre (*shih vendimet nr. 82, datë 21.12.2017; nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Kolegji vë në dukje se marrja e provave në procesin penal rregullohet nga nenet 149-152 të KPP-së. Midis të tjerave, këto dispozita parashikojnë se provat merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë nëse prova vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit (*neni 149*). Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren, ndërsa papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Për përjashtimin e provave të ndaluara nga ligji ose ato që janë haptazi të panevojshme vendos gjykata e zakonshme gjatë gjykimit (*neni 151*).

20. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji do të analizojë nëse ky pretendim ka marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme dhe nëse përgjigjja përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të drejtë dhe pa gabime. Në këtë pikë, duhet theksuar se kontrolli kushtetues i vendimeve gjyqësore kufizohet në mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit dhe nuk përfshin çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, përveçse kur ato cenojnë këto të drejta (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn kur gabimi ligjor ose faktik është haptazi i dukshëm ose i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në këtë këndvështrim, Kolegji vëren se në lidhje me procesverbalin e sekuestrimit të sendit "dorezë e zezë", gjykatat kanë arsyetuar se përshkrimi më i detajuar nga eksperti i ngjyrës së brendshme të saj nuk ndryshon llojin ose identitetin e sendit të këqyrur, sekuestruar dhe ekzaminuar dhe, për rrjedhojë, nuk ndikon në vlefshmërinë e procesverbalit ose në marrjen e tij si

provë materiale. Sipas tyre, doreza është përshkruar në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe është pasqyruar në tabelat fotografike, ku dallohen qartë materiali, ngjyra dhe dëmtimet e saj, elemente që mundësojnë individualizimin e sendit. Gjykatat kanë vlerësuar gjithashtu se këqyrja dhe sekuestrimi i dorezës janë kryer në përputhje me nenet 188, 300 dhe 301 të KPP-së, duke respektuar rregullat dhe afatet procedurale për marrjen, sekuestrimin dhe dërgimin e provës materiale për ekzaminim. Po kështu, ato kanë konstatuar se procesverbali i këqyrjes, ai i sekuestrimit, akti i ekspertimit biologjik dhe tabelat fotografike përkatëse nuk paraqesin pasaktësi dhe paqartësi, por përputhen me njëri-tjetrin, ndërsa i gjithë procesi i marrjes, i ruajtjes dhe i ekzaminimit të provës është zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale penale.

22. Në lidhje me pretendimin për falsitetin e aktit të ekspertimit biologjik për shkak të datës së gabuar, gjykata e ka vlerësuar atë të pabazuar, duke arsyetuar se data në krye të tij është gabim material dhe se data e saktë e kryerjes së aktit përcaktohet nga përmbajtja e tij dhe formulari i ekzaminimit të përgjithshëm, bashkëlidhur atij. Për rrjedhojë, sipas gjykatës, në zbatim të nenit 100, pika 2, të KPP-së, data në aktin e ekspertimit nuk vë në dyshim origjinalitetin e aktit, në kushtet kur data mund të përcaktohet nga elementet e dokumentacionit shoqërues.

23. Gjithashtu, gjykatat kanë rrëzuar pretendimet për paligjshmërinë e deklarimeve të të dy shtetasve përpara oficerit të Policisë Gjyqësore, duke arsyetuar se ato janë dhënë në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale dhe jo si persona nën hetim ose të pandehur. Sipas tyre, ndalimi ligjor i përdorimit të deklarimeve vetinkriminuese zbatohet vetëm ndaj deklaruesit dhe jo ndaj personave të tretë. Gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në përputhje me nenet 167 dhe 370 të KPP-së, si për thirrjen e dy shtetasve në gjykim në cilësinë e të bashkëpandehurve në një procedim të lidhur dhe respektimin e së drejtës së njërit prej tyre për të mos u përgjigjur, ashtu edhe për leximin e deklarimeve të dhëna gjatë hetimit. Në veçanti, për njërin prej tyre, i cili ka refuzuar të përgjigjet në gjykim, është lejuar leximi i deklarimeve të dhëna gjatë hetimit, ndërsa për tjetrin leximi është lejuar pasi, pavarësisht kërkimeve të kryera, nuk ishte bërë e mundur prania e tij në gjykim dhe nga sistemi TIMS rezultonte se ishte larguar nga Shqipëria në vitin 2022. Gjykatat kanë vlerësuar gjithashtu se këto deklarime nuk përbënin dëshmi indirekte në kuptim të nenit 154 të KPP-së, pasi deklaruesit kanë treguar fakte të përjetuara prej tyre, si takimet, komunikimet dhe lëvizjet e kryera së bashku me kërkuesit, dhe jo fakte të mësuara nga persona të tretë. Së fundmi, rëndësia dhe fuqia provuese e këtyre deklarimeve janë vlerësuar në tërësi dhe në raport me provat e tjera të shqyrtuara në gjykim. Për rrjedhojë, gjykatat i kanë

vlerësuar të pabazuara pretendimet e mbrojtjes për mënyrën e marrjes dhe përdorimit të këtyre deklarimeve në proces.

24. Për sa më lart, Kolegji çmon se, në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuesit, gjykatat e zakonshme kanë shqyrtuar pretendimet për paligjshmërinë e marrjes dhe përdorimit të provave dhe u kanë dhënë atyre përgjigje të arsyetuar, duke vlerësuar se provat e kundërshtuara janë marrë në përputhje me rregullat procedurale penale dhe janë të përdorshme. Nuk rezulton që arsyetimi dhe përfundimet e gjykatave të zakonshme në këtë drejtim të përmbajnë gabime ligjore ose faktike haptazi të dukshme, të tilla që t'i bëjnë ato arbitrare në kuptimin kushtetues. Po kështu, vlera e tyre provuese nuk është vlerësuar në mënyrë të izoluar, por në raport me tërësinë e provave të administruara, mbi bazën e të cilave gjykatat kanë arritur në përfundimin për fajësinë e kërkuesve. Provat i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe, duke qenë se gjykimi është zhvilluar sipas ritit të procedurës së zakonshme, kërkuesit kanë pasur mundësi t'i njohin, kundërshtojnë dhe debatojnë ato. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se nuk rezulton që provat e kundërshtuara të jenë marrë në shkelje të ndonjë ndalimi ligjor ose që mënyra e marrjes, përdorimit dhe vlerësimit të tyre ta ketë bërë procesin gjyqësor, të vlerësuar në tërësinë e tij, të padrejtë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve është haptazi i pabazuar.

25. Lidhur me pretendimin për cenimin e *lirisë së lëvizjes dhe parimit të sigurisë juridike*, kërkuesit kanë parashtruar se masat e dënimit të caktuara ndaj tyre nuk janë në raport të drejtë me rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe pasojën e shkaktuar, si dhe me dënimet e caktuara nga gjykatat shqiptare në raste të ngjashme (*shih supra paragrafin 6.3.*).

26. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë thelbin e argumenteve të parashtruara, do ta analizojë këtë pretendim në këndvështrim të proporcionalitetit të dënimit me burgim, i cili përbën kufizim të lirisë personale të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës. Sipas pikës 2, shkronja "a", të këtij neni, liria e personit mund të kufizohet kur ai është dënuar me burgim nga gjykata kompetente. Një kufizim i tillë synon mbrojtjen e interesit publik për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike nga kriminaliteti. Për rrjedhojë, çështja që shtrohet për vlerësim është nëse, në rrethanat konkrete të çështjes, masa e dënimit me burgim e caktuar ndaj kërkuesve respekton kërkesën kushtetuese të proporcionalitetit.

27. Në këtë këndvështrim, Kolegji vëren se kërkuesit janë dënuar për veprën penale të vrasjes në rrethana cilësuese, të kryer në bashkëpunim dhe të mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 79, shkronja "dh", në lidhje me nenet 22 dhe 25 të KP-së, ndërsa njëri prej tyre është dënuar edhe për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i

parë, i KP-së. Për veprën e parë, kërkuesit janë dënuar respektivisht me 25, 30, 33 dhe 35 vjet burgim, ndërsa njëri prej tyre edhe me 7 vjet burgim për veprën penale të armëmbajtjes pa leje.

28. Neni 79, shkronja "dh", i KP-së parashikon se vrasja me dashje e kryer kundër dy ose më shumë personave dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm, ndërsa neni 278, paragrafi i parë, i po këtij kodi parashikon dënim me burgim nga 5 vjet deri në 7 vjet për mbajtjen pa leje të armëve, armëve shpërthyese ose lëndëve plasëse në automjete, në mjedise publike ose mjedise të hapura për publikun.

29. Lidhur me individualizimin e dënimit, gjykata e shkallës së parë ka mbajtur parasysh rrezikshmërinë e veprës penale duke analizuar rrethanat konkrete lidhur me numrin tre të personave që synoheshin të vriteshin, vendin publik, kohën dhe mënyrën e kryerjes së saj; kryerjen e saj në bashkëpunim si rrethanë rënduese dhe rolin konkret të secilit kërkues si organizator, ekzekutor ose ndihmës; faktin se vepra ka mbetur në tentativë, afërsinë e ardhjes së pasojës dhe shkaqet e mosrealizimit të saj "bllokimi i armës", pasojën e ardhur në formën e plagosjes së një shtetasi; si dhe shkallën e fajësisë të secilit. Ajo ka vlerësuar gjithashtu moshën e kërkuesve, faktin se ishin të padënuar më parë, qëndrimin mohues të tyre ndaj veprës dhe mungesën e rrethanave të tjera lehtësuese të parashikuara nga neni 48 i KP-së. Për kërkuesin e dënuar edhe për armëmbajtje pa leje, gjykata ka marrë në konsideratë edhe rrezikshmërinë e kësaj vepre, kufijtë ligjorë të dënimit, kryerjen e dy veprave penale dhe rrethanën rënduese të përdorimit të armës. Ky vlerësim është gjetur i drejtë nga gjykatat më të larta, të cilat kanë lënë të pandryshuara masat e dënimit.

30. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se caktimi dhe individualizimi i dënimit për secilin kërkues është arsyetuar në raport me rrethanat konkrete të çështjes, rolin e secilit në kryerjen e veprës, pasojat e saj, si dhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Po kështu, për veprën penale të parashikuar nga neni 79, shkronja "dh", i KP-së, e cila dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm, gjykatat kanë caktuar për secilin kërkues dënim me burgim me afat, në masa të individualizuara nga 25 vjet deri në 35 vjet. Kolegji thekson se caktimi dhe individualizimi i dënimit u përket, në parim, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa kontrolli kushtetues mund të ndërhyjë vetëm kur masa e dënimit rezulton haptazi joproporcionale, si rrjedhojë e zbatimit arbitrar të ligjit penal ose e mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

31. Gjithashtu, nuk qëndron as pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, i mbështetur në argumentin se gjykatat shqiptare nuk kanë dhënë më parë dënime të tilla. Ky argument, përveçse përbën një përfundim të përgjithshëm, pa u shoqëruar me të dhëna konkrete ose me identifikimin e burimit shkencor mbi të cilin mbështetet, nuk është i mjaftueshëm për të

vënë në dyshim respektimin e këtij parimi. Për më tepër, në rastin e kërkuesve, gjykatat kanë caktuar dënimet sipas llojeve dhe masave të parashikuara nga ligji penal, duke i individualizuar ato në raport me rrethanat konkrete të çështjes dhe përgjegjësinë e secilit. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesve për cenimin e këtyre të drejtave dhe parimeve kushtetuese janë haptazi të pabazuara.

32. Lidhur me pretendimin për cenimin *e së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa i takon së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj* kërkuesit kanë parashtruar se kryesuesja e trupit gjykues që dha vendimin në gjykatën e shkallës së parë nuk kryente më atë funksion, pasi ishte deleguar si gjyqtare në Gjykatën e Apelit (*shih supra paragrafin 6.4.1.*).

33. Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nënkupton që çështja të shqyrtohet nga gjykata që ka juridiksion dhe kompetencë për ta gjykuar atë, kompetencë e cila duhet t'i jetë atribuar me ligj (*shih vendimet nr. 55, datë 07.11.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Kushtetuta në nenin 147/a, shkronja "a", të saj, ka parashikuar kompetencën e KLGJ-së për të transferuar gjyqtarët e të gjitha niveleve. Transferimi i gjyqtarëve, që mund të bëhet edhe me anë të një skeme delegimi, është detajuar në përmbajtje të nenit 45 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji për Statusin e Magjistratit*), në bazë të nevojave të një gjykate të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër. Në bazë të këtij parashikimi ligjor, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr. 30, datë 14.02.2019, për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme (*vendimi për procedurën e kandidatit në skemën e delegimit*) dhe vendimin nr. 22, datë 07.02.2019, të KLGJ-së, për funksionimin e skemës së delegimit të gjyqtarit (*vendimi për funksionimin e skemës së delegimit*). Sipas këtyre akteve, për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, KLGJ-ja cakton gjyqtar nga gjykata ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, në një gjykatë tjetër, kur kjo e fundit ka një nevojë konkrete që lidhet me gjykimin e një ose disa çështjeve gjyqësore. Në veçanti, sipas pikës 5 të nenit 5 të vendimit për funksionimin e skemës së delegimit, gjyqtari i deleguar përjashtohet nga shorti në gjykatën nga e cila vjen, por përfundon gjykimin e çështjeve që ka në shqyrtim.

35. Po kështu, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pohuar se shprehja "e caktuar me ligj" në kuptim të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetekzistencën e një "gjykate", por edhe përbërjen e trupit gjykues në secilin rast (*shih*

Buscarini kundër San Marinos (vendim), 04.05.2000; Richert kundër Polonisë, 25.10.2011, § 43; Ezgeta kundër Kroacisë, 07.09.2017, § 38). Ndërsa fjala "ligj" përfshin në veçanti legjislacionin mbi krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore (*shih Lavents kundër Letonisë, 28.11.2002, § 114; Richert kundër Polonisë, 25.11.2011, § 41; Jorgic kundër Gjermanisë, 12.07.2007, § 64*), por edhe çdo dispozitë tjetër e ligjit të brendshëm, e cila, nëse shkelet, do ta bënte të paligjshme pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një çështjeje (*shih Pandjikidze dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë, 27.10.2009, § 104; Gorgiladze kundër Gjeorgjisë, 20.10.2009, § 68*).

36. Në kontekst të sa më sipër, Kolegji vëren se, në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuesit, ky pretendim ka marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme, të cilat e kanë vlerësuar atë të pabazuar. Nga arsyetimi i vendimeve të tyre rezulton se çështja e kërkuesve është gjykuar në shkallë të parë nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë. Njëra prej gjyqtareve, njëherazi kryesuese e trupit gjykues, ushtronte funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, por ishte caktuar nga KLGJ-ja, me vendimin nr. 1, datë 07.01.2022, për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për shkak të pamjaftueshmërisë së numrit të gjyqtarëve në atë gjykatë. Gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë, me vendimin nr. 229, datë 20.06.2022 të KLGJ-së, gjyqtarja në fjalë është komanduar në skemën e delegimit dhe është caktuar përkohësisht në Gjykatën e Apelit Vlorë. Ky vendim mbështetej, ndër të tjera, në shkronjën "a" të pikës 4 dhe pikën 7 të nenit 45 të Ligjit për Statusin e Magjistratit, si dhe në vendimin e KLGJ-së, për funksionimin e skemës së delegimit të gjyqtarit, pas vlerësimit të nevojave të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe plotësimit nga gjyqtarja të kritereve ligjore përkatëse. Në zbatim të këtyre parashikimeve, gjyqtarja ka vijuar dhe ka përfunduar gjykimin e çështjes së kërkuesve. Edhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar se delegimi i saj nuk cenonte kompetencën e trupit gjykues dhe as kërkesën kushtetuese për një gjykatë të caktuar me ligj (*shih vendimit të Gjykatës së Lartë paragrafi 62.3.*).

37. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se nuk rezultojnë shkelje me natyrë kushtetuese në pjesëmarrjen e gjyqtares në shqyrtimin dhe dhënien e vendimit, të tilla që të vënë në dyshim respektimin e standardit të gjykatës së caktuar me ligj. Caktimi i përkohshëm i saj për ushtrimin e detyrave të tjera, duke ruajtur njëkohësisht detyrimin për të përfunduar çështjet që kishte në shqyrtim, është bërë në përputhje me kuadrin ligjor dhe vendimmarrjen e KLGJ-së, si organ kushtetues, i cili ka përgjegjësinë ligjore për caktimin e gjyqtarëve, në funksione të ndryshme, sipas një skeme delegimi. Në këto rrethana, vijimi i shqyrtimit të çështjes nga gjyqtarja nuk rezulton të ketë cenuar rregullat ligjore për formimin dhe përbërjen e trupit gjykues. Për rrjedhojë,

pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

38. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* kërkuesit kanë parashtruar se Gjykata e Apelit ka qenë e njëanshme, pasi një prej anëtarëve të trupit gjykues është caktuar 2 ditë përpara shpalljes së vendimit (*shih supra paragrafin 6.4.2.*).

39. Kolegji konstaton se, në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuesit, çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit në datën 27.03.2023 dhe, për shkak të largimit të gjyqtarit relator, është rishortuar në datën 04.09.2023, duke iu caktuar një gjyqtari tjetër. Brenda së njëjtës ditë, Këshilli i Gjykatës ka plotësuar përbërjen e trupit gjykues edhe me dy gjyqtarë të tjerë. Përbërja e trupit gjykues u është komunikuar palëve, përfshirë mbrojtësit e kërkuesve, në seancën gjyqësore të datës 14.09.2023, të cilët janë shprehur se nuk kishin kundërshtime. Në përfundim të seancës, trupi gjykues është tërhequr për vendim, duke njoftuar shpalljen e tij për të nesërmen. Në datën 15.09.2023, përpara shpalljes së vendimit, mbrojtësit kanë kërkuar përjashtimin e një prej gjyqtarëve. Kërkesa është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër dhe është rrëzuar si e pabazuar, pas së cilës trupi gjykues ka shpallur vendimin përfundimtar (*shih vendimin e Gjykatës së Apelit faqet 17-18*).

40. Procedura e ndjekur nga Gjykata e Apelit është bërë objekt shqyrtimi edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e kërkuesve. Sipas saj, parimi i paanshmërisë nuk lidhet drejtpërdrejt me kohën që anëtari i trupit gjykues ka pasur në dispozicion për shqyrtimin e dosjes, por me ekzistencën e sjelljeve, veprimeve, mendimeve ose këshillave nga të cilat mund të deduktohet bindshëm njëanshmëria e tij (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë paragrafi 66*).

41. Për sa më lart, Kolegji vëren se caktimi i gjyqtares në përbërje të trupit gjykues në datën 04.09.2023 dhe koha në dispozicion të saj deri në shqyrtimin e çështjes dhe shpalljen e vendimit, në vetvete, nuk përbëjnë rrethana që të vënë në dyshim paanshmërinë e saj. Kërkuesit nuk kanë parashtruar fakte ose rrethana konkrete që të përmbysin prezumimin e paanshmërisë sipas testit subjektiv dhe testit objektiv, të tilla që të krijojnë dyshime të përligjura për njëanshmërinë e gjyqtares. Për më tepër, pretendimi i tyre është shqyrtuar dhe ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e zakonshme, përfshirë Gjykatën e Lartë, arsyetim i cili nuk rezulton arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm në kuptimin kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar.

42. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për t'u mbrojtur, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit,* kërkuesit kanë parashtruar se dy gjykatat e faktit u kanë refuzuar kërkesat për marrjen e disa provave, si: (i) rindërtimi i vendit të ngjarjes; (ii) pyetjet e ekspertëve që kishin kryer ekspertimet biologjike dhe balistike; (iii) pyetja e një eksperti të komunikimit celular; (iv) pyetja e tri viktimave, që ishin kërkuar si dëshmitarë edhe nga prokurori; pyetjet e 11 dëshmitarëve të tjerë, nga të cilët 5 ishin kërkuar edhe nga prokurori; (v) ballafaqimi mes 3 shtetasve dhe kërkuesve (*shih supra paragrafin 6.4.3.*).

43. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se parimi i kontradiktoritetit në gjykim dhe ai i barazisë së armëve kërkojnë krijimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose të përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe për deklarimet e tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e mbrojtjes në procesin penal mund të cenohet nëse refuzohet kërkesa e mbrojtësit për thirrjen e dëshmitarëve. Megjithatë, i akuzuari për të mbështetur pretendimin se i është cenuar e drejta e mbrojtjes për këtë shkak, duhet të bëjë të besueshme se pyetja e dëshmitarëve ishte e domosdoshme për të përcaktuar të vërtetën. Nëse gjykatat e zakonshme çmojnë se dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, ato mund ta refuzojnë kërkesën për thirrjen e dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë (*shih vendimin nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Kolegji vëren se gjatë gjykimit përpara gjykatave të faktit, kërkuesit janë përfaqësuar rregullisht nga mbrojtësit e zgjedhur prej tyre. Nga vendimet gjyqësore rezulton se, përmes mbrojtësve, ata kanë pasur mundësi të debatojnë provat dhe të kërkojnë marrjen e provave të reja, ndërsa për kërkesat e papranuara kanë marrë përgjigje të arsyetuara. Në veçanti, për kërkesën e mbrojtjes për pyetjen e viktimave dhe të dëshmitarëve, gjykata e shkallës së parë fillimisht ka lejuar marrjen e tyre si prova dhe ka ndërmarrë veprime për thirrjen e tyre. Për disa prej dëshmitarëve, ajo u ka kërkuar mbrojtësve të vendosnin në dispozicion adresat dhe ka shtyrë disa seanca për këtë qëllim. Megjithatë, për një periudhë të konsiderueshme mbrojtja nuk ka siguruar adresat e tre prej dëshmitarëve, ndërsa një dëshmitare tjetër (motra e njërit prej kërkuesve) nuk është paraqitur pavarësisht njoftimeve të dërguara në dy adresat e dhëna nga mbrojtja. Gjykata, pasi i ka dhënë mundësi mbrojtjes të siguronte adresat e dëshmitarëve, ka vlerësuar se pasiviteti i saj në këtë drejtim po sillte zvarritjen e procesit dhe ka revokuar vendimin e ndërmjetëm për marrjen e këtyre provave. Kjo vendimmarrje është vlerësuar e drejtë nga Gjykata e Apelit, e cila ka evidentuar edhe faktin se njëra prej dëshmitareve ishte motra e njërit prej

kërkuesve dhe thirrja e saj mund të realizohej lehtësisht, ndërsa Gjykata e Lartë nuk e ka cenuar vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta për këtë shkak.

45. Po kështu, gjykata e shkallës së parë, pasi ka shqyrtuar kërkesat e tjera të mbrojtjes për marrjen e provave, ka rrëzuar kërkesat për pyetjen e ekspertëve biologjikë dhe balistikë që kishin kryer aktet e ekspertimit gjatë hetimit paraprak, kryerjen e eksperimentit dhe të ekspertimit nga një inxhinier elektronik, si dhe për pyetjen si dëshmitarë të ekspertëve balistikë, kriminalistikë dhe biologjikë të zgjedhur nga mbrojtja. Ajo ka arsyetuar se aktet e ekspertimit ishin të plota e të qarta dhe i ishin nënshtruar debatit gjyqësor, ndërsa çështjet për të cilat kërkohej pyetja e ekspertëve ose rezultonin nga vetë aktet dhe dokumentacioni shoqërues, ose tejkalonin objektin e ekspertimit. Po kështu, gjykata ka vlerësuar se nuk ishte i nevojshëm rindërtimi i ngjarjes, pasi ajo rezultonte e filmuar nga kamerat e administruara si provë, ndërsa të dhënat për vendndodhjen e kërkuesve rezultonin nga informacioni teknik i kompanive celulare, i administruar dhe analizuar gjatë gjykimit. Për ekspertët e zgjedhur nga mbrojtja, gjykata ka arsyetuar se ata nuk mund të pyeteshin si dëshmitarë, pasi nuk kishin dijeni për faktet objekt gjykimi dhe mbrojtja nuk kishte paraqitur ndonjë akt ekspertimi të hartuar prej tyre. Edhe kërkesat për ballafaqim janë rrëzuar për shkak të mosplotësimit të kushteve të nenit 169 të KPP-së.

46. Në vijim, Gjykata e Apelit ka arsyetuar gjerësisht se provat e marra në gjykimin në shkallë të parë i janë nënshtruar debatit gjyqësor dhe mbrojtja ka pasur mundësi të parashtrojë qëndrimin e saj për to, përfshirë pretendimet për papërdorshmërinë e tyre. Sipas saj, kërkesat për prova të tjera janë vlerësuar në përputhje me nenet 151 dhe 357 të KPP-së dhe janë çmuar të panevojshme për zgjidhjen e çështjes, ndaj nuk plotësonin as kushtet e nenit 427 të KPP-së për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor.

47. Edhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar se pretendimet e mbrojtjes për pavlefshmërinë ose papërdorshmërinë e provave dhe për mospranimin e provave të kërkuara ishin shqyrtuar në mënyrë ezauruese nga Gjykata e Apelit. Sipas saj, kjo e fundit nuk i kishte rrëzuar *apriori* kërkesat e mbrojtjes, por kishte individualizuar secilën prej tyre dhe kishte arsyetuar përse nuk plotësoheshin kushtet ligjore për marrjen e provave ose përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë paragrafët 64 - 67*).

48. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesve u është garantuar mundësia efektive për të marrë pjesë në proces, për të kundërshtuar dhe debatuar provat e paraqitura nga organi i akuzës, si dhe për të kërkuar marrjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tyre. Në këtë drejtim, fakti që një pjesë e kërkesave të tyre për prova nuk është pranuar nuk tregon, në vetvete, cenim të parimit

të barazisë së armëve, për sa kohë gjykatat i kanë shqyrtuar këto kërkesa dhe kanë dhënë arsye konkrete për rrëzimin e tyre. Po kështu, nuk rezulton që organit të akuzës t'i jenë njohur përparësi procedurale ose mundësi që u janë mohuar kërkuesve. Për rrjedhojë, nuk rezulton që kërkuesit të jenë vendosur në një pozitë të pafavorshme ndaj organit të akuzës në paraqitjen dhe mbrojtjen e çështjes së tyre, ndaj pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve është haptazi i pabazuar.

49. Lidhur me pretendimin për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, kërkuesit kanë parashtruar se vendimet e të tria gjykatave janë voluminoze për shkak të përsëritjes së rrethanave të faktit dhe pretendimeve të mbrojtjes, ndërsa arsyetimi i tyre mbetet nën standardin e kërkuar. Sipas tyre, kjo është veçanërisht e dukshme në vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila, ndonëse e ka arsyetuar vendimin vetëm në tri faqe, u ka dhënë përgjigje të pjesshme shkaqeve të rekursit dhe është mjaftuar me formulime të përgjithshme (*shih supra paragrafin 6.4.4.*).

50. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se arsyetimi i vendimit gjyqësor është element thelbësor i një vendimi të drejtë, pasi u tregon palëve se janë dëgjuar dhe u mundëson kundërshtimin e vendimmarrjes. Masa e arsyetimit ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes dhe natyrës së vendimit (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit dhe arsyetimi të shprehë, në thelb, shkaqet e mospranimit të tij gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Në rastin konkret, nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të faktit rezulton se ato kanë shqyrtuar pretendimet e kërkuesve dhe kanë dhënë arsyet për mospranimin e tyre, të mbështetura në provat e administruara dhe dispozitat ligjore të zbatueshme, pa rezultuar arsyetim arbitrar ose haptazi i pamjaftueshëm. Edhe Gjykata e Lartë ka pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit shkaqet e rekursit, përfshirë pretendimet me natyrë kushtetuese, si dhe u ka dhënë atyre përgjigje përmes një arsyetimi të kufizuar, por të mjaftueshme për natyrën e vendimmarrjes së mospranimit të rekursit në dhomën e këshillimit. Në këtë drejtim, gjatësia e arsyetimit ose numri i faqeve të vendimit nuk përcakton, në vetvete, përmbushjen e standardit kushtetues, për sa kohë arsyetimi është i qartë, u jep përgjigje çështjeve thelbësore të ngritura dhe mundëson kontrollin e vendimmarrjes. Për rrjedhojë, fakti se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me një

arsyetim të kufizuar nuk mjafton për të vënë në dyshim rregullsinë kushtetuese të procesit të zhvilluar përpara saj, ndaj pretendimi i kërkuesve është haptazi i pabazuar.

52. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.